

Çka do të thotë sot në botën e globalizuar socialdemokracia?
Ç'është demokracia sociale?

A është i mjaftueshëm interesimi i qytetarëve për politikë?
A mund të ngjallet serish interesimi i tillë?

A janë kompatible dinamika ekonomike dhe drejtësia sociale?
Cilat politika konkrete janë treguar të aplikueshme?

Sa kanë qenë ato të suksesshme?

Këto dhe pyetjet e tjera janë të rëndësishme në të gjitha rajonet e botës. Përmes editimit të publikimit "**Forumi demokracia sociale – vizionet dhe opsionet për Evropën Juglindore**" Fondacioni Fridrih Ebert (Friedrich-Ebert-Stiftung) dëshiron të jap kontributin e vet në debatin që zhvillohet në Evropën Juglindore në këtë temë. Publikimet do të përcillen nga forumi në internet (www.forum-social-democracy.org). I ftojmë të gjithë lexuesit të marrin pjesë aktive në këto debate.

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Beograd
Simina 1
11000 Beograd
Serbi dhe Mali i Zi

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Sarajevë
Sumbula Avde 7
71000 Sarajevë
Bosnjë dhe Hercegovinë

Fondacioni Fridrih Ebert
Zyra në Zagreb
Prashka 8
10000 Zagreb
Kroaci

- Teksti del edhe në gjuhën maqedone, shqipe, bullgare dhe rumune.
- Të gjitha tekstet mund të gjenden në internet, në www.fes.org.yu

Si në kontratat e Unionit Evropian, ashtu edhe në deklaratat e Këshillit të Evropës, pranohet që modeli social evropian është element i rëndësishëm i procesit evropian të integritimit. Mirëpo, cila përmbajtje duhet të ndërlidhet me nocionin e modelit social evropian? Në botën e OECD-së, në të vërtetë, ekzistojnë modelet nga më të ndryshmet të mirëqenies, siç është modeli anglosakson (liberal), nordik (universal, socialist), kontinental-evropian (i korporacioneve), apo modeli mediteran (i korporacionit, i mbështetur në traditë dhe familje). Kur kemi të bëjmë me modelin social, hulumtimet empirike janë të orientuara ndaj institucioneve dhe politikanëve, që disa sfera i përjashtojnë nga ndikimi i tregut dhe, në vend të kësaj, dëshirojnë që në aspektin shoqëror, përkatësisht politik t'i formësojnë kushtet jetësore të individëve dhe të grupeve sociale. Në qendër të vëmendjes në shumicën e rasteve gjendet sigurimi social, politika shtetërore sociale dhe politika tatimore. Unioni Evropian, më shumë se kurrë, sot është i larguar nga modeli i vetëm social evropian. Krahas diferencës në rritje të mirëqenies së shteteve evropiane, është e mundur, ndërkaq, të vërehet ekzistimi i një elementi të përbashkët: vetëdija që drejtësia sociale dhe baraspesha sociale (mund të) japin kontributin e tyre pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe se nuk janë vetëm faktor i të dalave (shpenzimeve), siç do të duhej anasjelltas që zhvillimi ekonomik të manifestohej pozitivisht në ekuilibrin social.

Lotar Vite – dr Hajnrih Zassenfeld¹
(Lothar Witte – Dr. Heinrich Sassenfeld)

Ndikimi i Unionit Evropian në modelin social evropian dhe në kohezionin social

A mund që ardhmëria në Evropë të formësohet në mënyrë individuale për vendet e reja anëtare?

Nga ç' masë e sovranitetit nacional duhet të heqë dorë shteti si vend anëtar i UE-së?

Teksti që është para nesh tenton të përgjigjet në këto pyetje në zbatimin e politikës sociale. Është treguar që:

- politika sociale evropiane gjer më tani ka qenë më shumë si fantom, se sa realitet
- me ndihmën e politikës sociale nacionale sigurohen zgjidhje shumë të ndryshme
- politika e përbashkët ekonomike ndikon në masë të konsiderueshme në pasojat sociale.

Ky tekst paraqet literaturën e detyrueshme për të gjithë politikanët në rajon, të cilët dëshirojnë ta përparojnë zhvillimin e vendeve të veta, duke mos e humbur nga vëmendja drejtësinë sociale.

¹ Është ky versioni i përpunuar i shkurtër i publikimit të Lotar Vite: "Modeli social evropian dhe kohezioni social: çfarë roli luan UE?" Fondacioni Fridrih Ebert, Bon, Analiza ndërkombëtare politike, dhjetor 2004.

Modeli social evropian: Kërkesë, por shumë realitete të ndryshme

Për t'iu afruar sado pak subjektit të diskutimit, propozojmë këtë përkufizim:

Modeli social evropian përshkruan tërësinë e aksioneve të shtetit dhe të shoqërisë civile, që janë të orientuara në atë drejtim që të gjithë qytetarëve dhe qytetareve:

- t'ua plotësojnë nevojat (themelore) materiale,
- t'u sigurohet angazhimi shoqëror,
- të forcohet kohezioni social.

Qëllimet veç e veç të këtij sistemi nuk janë të përkufizuara në mënyrë rigoroze, ato pjesërisht kushtëzohen në mes veti.

Cilësia dhe sasia e asaj që nënkuptohet me nivelin përkatës material, angazhimin e gjerë shoqëror dhe me kohezionin e fuqishëm social, janë po ashtu kategori të ndryshueshme. Ato varën nga mundësitë ekonomike dhe nga marrëdhëniet shoqërore të fuqive. Modeli social evropian është detyrimisht subjekt i ngatërresave shoqërore dhe i konflikteve politike, e si i tillë edhe dinamik.

A ekziston kampioni evropian? Apo: cili shtet çka ka arritur?

Po qe se vendet evropiane vështrohen veç e veç, duhet që në bazë të indikatorëve konkret të vlerësohet në çfarë mase vërtetë janë arritur qëllimet e kërkuara. Në tabelën 1, në shtojcë, janë paraqitur indikatorët social. Për përmbushjen e nevojave materiale, përveç të ardhurave për krye të banorit, është marrë parasysh edhe i ashtuquajtimi "shekulli i shëndoshë i jetës", duke qenë se përmes tij vërehet niveli i përmbushjes së nevojave materiale në fushat e ndryshme të jetës: të ardhurat, ushqimi, gjendja banesore etj. Kur kemi të bëjmë me angazhimin shoqëror si parakusht vështrohet arsimimi, por me rëndësi është edhe pjesëmarrja në politikë dhe në shoqërinë civile (dalja në zgjedhje, anëtarësia në organizata). Ndikim qendror në kohezionin social ka shpërndarja e të ardhurave, me ç'rast pasqyra negative konsiston, p.sh., në shpeshhtësinë e krimeve të dhunshme dhe numrin e të burgosurve.

Po qe se i vështrojmë shtetet e OECD-së, kemi këtë pasqyrë:

- Shtetet skandinave paraqesin karakteristikën ekzemplare të modelit social, i cili ndërlihd përmbushjen e nevojave materiale me angazhimin shoqëror dhe kohezionin social.
- Shtetet që përbëjnë "bërthamën" e Evropës kontinentale, me përjashtim të Holandës, sa u përket indikatorëve, gjenden në mesin solid.
- Kur kemi të bëjmë me vendet e Evropës Jugore, Italia dhe Spanja e mbajnë mirë hapin në sferën materiale, por e humbin garën kur kemi të bëjmë me angazhimin shoqëror dhe kohezionin social. Portugalia dhe Greqia thuhet se sipas të gjithë indikatorëve gjenden pas vendeve "anëtarë të vjetër" të Unionit Evropian.
- Çekia, Hungaria dhe Polonia, sa i përket çështjes së përmbushjes së nevojave ma-

teriale në përputhje me pritjet, duhet të kompensojnë shumë çka në krahasim me të gjitha shtetet e tjera – anëtare të Unionit Evropian. Kur kemi të bëjmë me angazhimin shoqëror dhe kohezionin social, rezultati është vërtetë më i keq se në shtetet që përbëjnë “bërthamën” e Evropës, por nga ana tjetër krahasohet me nivelin e vendeve të Afrikës Jugore, apo është ndoshta edhe më i mirë.

- Shtetet anglosaksone i karakterizon një rezultat i mirë kur kemi të bëjmë me nivelin material

dhe angazhimin shoqëror, por pozicioni shumë i dobët po të shikohet kohezioni social.

Bie në sy që vetëm në shtetet anglosaksone, rezultati i një indikatorit, i kohezionit social, në aspektin negativ, dallohet (është më lart) nga pamja e gjithmbarshme për atë grup të shteteve. Kjo e mbështet supozimin që shtetet anglosaksone, vërtetë, dëshirojnë të ndjekin rrugën tjetër, se që është rasti me vendet e tjera industriale, sepse kur të shikohen kushtet materiale dhe shoqërore tashmë i kanë parakushtet e nevojshme për një kohezion më të lartë social.

Çfarë levash kemi në dispozicion për formësimin e modelit social?

Fushat më të rëndësishme politike për modelin social evropian janë politika ekonomike dhe politika e punësimit, politika fiskale, politika sociale dhe politika e arsimit, sepse

Politika ekonomike dhe politika e punësimit:

- i krijojnë parakushtet për përmbushjen e nevojave materiale,
- caktojnë shpërndarjen primare,
- i sigurojnë mjetet financiare për udhëheqjen e politikës sociale dhe masat që duhet të ndërmerren me qëllim të rishpërndarjes së mjeteve,
- i krijojnë dhe përmirësojnë parakushtet e përparimit ekonomik,
- i kontribuojnë krijimit të stabilitetit shoqëror dhe politik;

Politika sociale/sistemet e sigurisë sociale/politika fiskale:

- përcaktojnë shpërndarjen sekondare të të ardhurave (sipas transfereve), në ç’mënyrë i krijojnë suazat për stabilitet shoqëror dhe politik dhe sigurojnë që edhe ata, të cilët për shkak të mundësive të tyre të pamjaftueshme për punësim dhe fitim, nuk janë në masë të mjaftueshme në një situatë të tillë, megjithatë mund t’i përmbushin nevojat e veta dhe të angazhohen në aspektin shoqëror;

Politika e arsimit:

- ua përmirëson qytetarëve mundësitë për punësim dhe fitim, në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë,
- siguron parakushtet për përparim ekonomik,
- ua lehtëson angazhimin në jetën shoqërore.



Kutia me veglat e Unionit Evropian

Ndikimi në fushat politike del pikë së pari nga normat që paraqesin ndonjë ndalesë, para së gjithash ndalimin e diskriminimit dhe të kufizimit të lirive themelore, si dhe ndalimin e diskriminimit gjinor. Ato konkretizohen dhe plotësohen përmes legjislacionit evropian (e drejta sekondare), që bazohet në ndarjen e kompetencave ndërmjet UE-së dhe vendeve anëtare.

Kompetencat më të rëndësishme ekskluzive të UE-së kanë të bëjnë me politikën monetare, politikën e konkurrencës, politikën e përbashkët tregtare dhe politikën e përbashkët agrare. Në mesin e kompetencave që nuk bëjnë pjesë ekskluzivisht në fushëveprimin e UE-së duhet përmendur harmonizimin e dispozitave nacionale juridike dhe administrative me qëllim të funksionimit të tregut

të brendshëm të UE-së, pastaj kompetencat në fushën e lirisë së lëvizjes së personave dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve.

Fushat e kompetencave negative janë politika e punësimit, sistemi i arsimit, organizimi i shëndetësisë, raportet industriale dhe siguria sociale.

Në këto fusha politike veprimtaria e UE-së, për shkak të pamundësisë së harmonizimit, ka vetëm karakter plotësues dhe të avancues. Ka, ndërkaq, mundësinë e ndërhyrjes ashtu që i parashtron normat të cilat paraqesin një lloj ndalesë, nxjerr rregulla dhe direktiva, si dhe rekomandime. Edhe metoda e re, "metoda e konkurrencës së hapur" paraqet një rrugë të rëndësishme drejt realizimit të ndikimit në procese.

Bërthamë e fortë: politika ekonomike e UE-së, presioni i konkurrencës dhe ndikimet sociale

Politika ekonomike e Unionit Evropian nuk ndikon vetëm në sasinë dhe cilësinë e prodhimit të të mirave dhe shërbimeve (dhe në këtë mënyrë në bazën për përmbushjen e nevojave materiale), por edhe në shpërndarjen e mirëqenies në aktorët e tregut (dhe në këtë mënyrë edhe në kohezionin social). Me rastin e integritit ekonomik vjen gjer te presioni i shtuar i konkurrencës, nga e cila për shkak të valutës së përbashkët nuk mund të mbrohemi me anë të politikës nacionale monetare. Në të njëjten kohë, kriteret e Kontratës së Mastrohittit dhe Pakti i stabilitetit dhe i shtimit ua kufizojnë

qeverive nacionale hapësirën e veprimit për ballafaqim me pasojat e integritit ekonomik.

A i kushton kujdes politika ekonomike e Unionit Evropian rritjes së ekonomisë dhe punësimit?

Që nga shfaqja e unionit monetar janë të rëndësishme kompetencat evropiane në fushën e politikës monetare. Përgjegjësia për politikën e monetare dhe të kursit i takon Bankës Qendrore Evropiane, ndërsa në fushën e politikës fiskale

vlejnë kriteret e Kontratës së Mastrohit dhe Pakti i stabilitetit dhe i shtimit.

Banka Qendrore Evropiane, sa i përket çështjes së politikës monetare dhe të kursit, tash për tash i përmbahet kursit konservativ. Koncepti momental i Paktit të stabilitetit dhe të shtimit, po ashtu, nuk i shkon për shtati përparimit dhe punësimit. Ai vetëm se parashikon ndëshkimin e vendeve deficitare, por nuk parashikon ndihmë për tejkalimin e krizës. Koordinimi makroekonomik i parashikuar në procesin e Këlnit, që në vështrim të politikës ekspansive do të mund të shfrytëzonte hapësirën e mbetur manovruese të politikës nacionale (politika e fitimeve, politika fiskale e vendeve me bilanc pozitiv ekonomik) për përparim dhe punësim, thuaja se as që ekziston.

Si ndikon politika ekonomike evropiane në ndarjen e mirëqenies?

Kur vështrohen efektet e shpërndarjes që i ka politika ekonomike e Unionit Evropian, është e nevojshme të dallohen më shumë procese:

- Shpërndarja primare e të ardhurave ndërmjet kapitalit dhe punës, si dhe shpërndarja e të ardhurave sipas vendeve të veçanta të UE-së;
- Rishpërndarja e vlerave të krijuara përmes transferenceve monetare njerëzve që disponojnë të ardhura të vogla apo kurrfarë të ardhurash (të moshuarit, të sëmurët, të paafitit për punë, të pa-punësuarit), që financohen nga tatimet dhe kontributet sociale;
- Shpërndarja ndërmjet shtimit të prodhimit dhe të ardhurave, si dhe të formave të tjera të rritjes së standardit (p.sh. koha e lire, marrja me familjen, pensioni i vjetërsisë);
- Vënia e të mirave dhe e shërbimeve publike (arsimi, shëndeti, siguria, infrastruktura, etj.) në dispozicion të gjithëve, pra pavarësisht nga pjesëmarrja në financim.

Unioni Evropian në masë të pakonsiderueshme, apo më mirë të thuhet indirekt ndikon në **ndarjen primare të të ardhurave ndërmjet kapitalit dhe punës**. Në të njëjtën masë më të madhe ndikon intenziteti i konkurrencës. Konkurrenca e fuqishme në tregun e të mirave shpie drejt zbritjes së çmimeve dhe në këtë mënyrë edhe gjërat të ardhurat më të mëdha reale për të gjithë konsumatorët. Po qe se nuk ka një konkurrencë të tillë dhe një rezultat të zbritjes së çmimeve, pjesëmarrja e zvogëluar e shpenzimeve të fitimit në njësinë e prodhimit i kontribuon rishpërndarjes në të mirë të profitit, ndërsa rriten edhe rendimentet e pronarit të kapitalit.

Liberalizimi i tregut manifestohet edhe në ndarjen e punës brenda Unionit Evropian. Nga kjo rrjed-

hin konsekuencat rreth çështjes së ndarjes brenda ekonomive nacionale. Në vendet e pasura – anëtare të BE-së, kërkesa për fuqi punëtore vendore më pak të kualifikuar është duke u zvogëluar, gjë që i kontribuon numrit gjithnjë e më rritje të të papunëve për një periudhë më të gjatë. Në vendet më të varfëra – anëtare të UE-së, rritet në të vërtetë kërkesa për fuqi punëtore, mirëpo për shkak të papunësisë së lartë hyrëse, rritja e fitimeve është shumë e ngadalësuar.

Në aspektin afatgjatë duhet pritur që fuqia më pak e kualifikuar punëtore në vendet e varfëra – anëtare të UE-së, në procesin e çvendosjes së pjesës së prodhimit në rrethin e tyre, do të bëjnë pjesë në "fitimtarë të procesit të integritit". Fuqia punëtore me kualifikime të larta në vendet me fitime të larta, si dhe pronarët e kapitalit me siguri se do të kenë profit nga integrimi në UE, ndërsa fuqia punëtore më pak e kualifikuar në vendet me fitime të larta më parë do të renditet në mesin e "humbësve të procesit të integritit". Pa mundësinë që kjo të dëshmohej në mënyrë empirike, konsiderohet që integrimi i tregut i Unionit Evropian do të mund të sillte rritjen e pabarazisë sociale në vendet e pasura – anëtare të UE-së dhe të zvogëlimit të saj në vendet e varfëra.

Ndikimi i Unionit Evropian në ndarjen sekondare

është edhe më i vogël. Shtetet – anëtare kanë sisteme shumë të ndryshme të financimit të të dhënave sociale të transferit. Nevoja për regulativë të drejtpërdrejtë evropiane ekziston vetëm për atë grupacion momentalisht të vogël njerëzish, që çvendosen nga një shtet në tjetrin, për të jetuar dhe punuar në to.

Masat për tejkalimin e ndryshimeve të mëdha në të ardhura kërkojnë hapësirë manovruese për politikë fiskale. Kjo hapësirë manovruese ndikon në integrimet evropiane me ekzistimin e konkurrencës së shtuar në lëmin e tatimit brenda fushës së integruar dhe me ekzistimin e ndalesës së financimit përtej mase të borxheve (do të thotë mbi 3% TPB).

Ndarja në mes të shtimit të prodhimit dhe të të ardhurave

dhe formave të tjera të rritjes së standardit vlerësohet në mënyrë të ndryshme në shoqëritë e pasura dhe të vjetra nga ato të reja dhe të varfëra. Shoqëritë e pasura dëshirojnë më shumë kohë të lirë, kanë më shumë nevojë për rindarje dhe preferenca më të fuqishme post materiale (mjedisi jetësor).



Këto rregulla ua kufizojnë vendeve të varfëra – anëtare të UE-së mundësitë për rritje më të shpejtë ekonomike. Unioni Evropian, pra, si kompensim ofron përparimin e rajonit (politika e kohezionit), përkundër asaj që suksesi i politikës së tillë ka qenë shumë modest.

Vënia në disponim për të gjithë e të mirave dhe shërbimeve publike, që financohen nga tatimi, pëson ndikimet e Paktit të stabilitetit dhe të shtimit, si dhe të politikës së konkurrencës. Trendi që e përkrah fuqishëm edhe Unioni Evropian, ndërkaq, sillet në drejtim të privatizimit të këtyre shërbimeve. Në këtë mënyrë efektet e deritashme të rindarjes zvogëlohen.

Përveç kësaj, edhe ofertuesit publik të këtyre shërbimeve varen nga dërgesat nga sektori pri-

vat, për të cilat, sipas rregullit, shpallen tenderë për tërë rajonin evropian. Në rastin më të mirë, konkurrenca që shfaqet në atë mënyrë, imponon lirim dhe/ose efektivitetin më të lartë të shërbimeve publike. Në atë rast eventualisht mund të pasojë rishpërndarja nga ofertuesit gjer më tani të mbrojtur, në të mirë të konsumatorëve, nga e cila përfitimin më të madh e kanë shfrytëzuesit e papunë të të ardhurave nga transferi i kapitalit.

Presioni i konkurrencës, ndërkaq, mjaft shpesh i imponuar nga zvogëlimi i shpenzimeve ndikon si në të ardhurat dhe në kushtet e punës në institucionet që janë në rolin e ofertuesit, ashtu edhe në cilësinë dhe përshtatshmërinë e ofertës.

Mbështjellësi i butë: Politika e punësimit, e arsimit dhe politika sociale

Unioni Evropian në politikën e punësimit, arsimit dhe në politikën sociale gjer në fund të viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar është kufizuar në një numër më të vogël “të masave dytësore” me qëllim të zhvillimit të tregut të përbashkët. Me miratimin e “Kartës sociale” (Karta e përbashkët e të drejtave themelore sociale të të punësuarve) në vitin 1989 është manifestuar konsenzusi politik që të drejtat themelore sociale të të punësuarve nuk paraqesin lëndë diskutimi (përfshirë Britania e Madhe). Në një Kontratë pak më të vonshme nga Mاستrihti, arsimit njihet si fushë e pavarur dhe juridikisht e bazuar e kompetencave të Unionit Evropian, vertetë me kufizime të mëdha të kompetencave.

Kontrata e Amsterdimit e vitit 1999 paraqet kthesë në kuptimin e rolit të politikës së punësimit, arsimit dhe të politikës sociale në Unionin Evropian. Për herë të parë në kuadër të politikës së punësimit nuk merren parasysh vetëm aspektet kualitative (si p.sh. siguria në vendin e punës), por në letër qitet (plotësohet) edhe kompetenca

e Unionit Evropian që përmes zhvillimit të strategjisë së koordinuar të punësimit të përparojë edhe niveli sasior i punësimit.

Duke u bazuar në Këshillin e Evropës, në Lisbonë në vitin 2000, si dhe nga procesi i Lisbonit që ka rrjedhë nga ai, politika e punësimit, e arsimit dhe politika sociale gradualisht bëhen së bashku lëndë me të cilën merren politikanët e Unionit Evropian, me ç'rast tregtia e Unionit Evropian është e kufizuar ngusht me formulime negative rreth çështjes së kompetencave.

Politika e punësimit: Është ofertë e rëndësishme

Direktivat e para të Unionit Evropian që kanë të bëjnë me politikën e punësimit shprehin përcaktimin për politikë aktive të tregut të punës. Procesit i Këlnit që është ndërlidhur me Këshillin e Evropës në Këln më 1999, është dashur që edhe më shumë ta ndërlidh politikën e punësimit si pjesë të dialogut makroekonomik me politikën

monetare apo fiskale. Çdo gjë, ndërkaq, ka mbetur në nivel të deklaratave mbi qëllimet.

Në procesin e Lisbonit politika e punësimit ka një parashenjë krejtësisht tjetër: depërton paradigma e konkurrencës. Është e nevojshme të menjanohen pengesat që kanë qendruar në anën e ofertës në rrugën e rritjes cilësore dhe sasiore të punësimit. Efektet e strategjisë evropiane të punësimit janë lëndë e kontesteve:

- Është me rëndësi që politika evropiane e punësimit të shqyrtohet si “laborator metodologjik” i Unionit Evropian. Për herë të parë shfrytëzohet metoda e koordinimit të hapur, përkatësisht në bazë të parakushteve të përbashkëta evropiane të qëllimeve hartohen planet e aksionit në nivelin kombëtar. Komisioni në raportin vjetor i harton edhe rekomandimet që janë specifike për çdo vend; ndërkaq, nuk ka mekanizma për sanksionim.
- Se në çfarë mase këto metoda shpiejnë vertetë drejt “politikës së mësimit” (policy of learning), është çështje e kontesteve. Po të vështrohet në mënyrë objektive, bartja e përvojave të politikës e cila merret me tregun e punës është e vështirë. Jashtë rrethit të opinionit profesionist raportet vjetore merrin që merren sa për njoftim.
- Kështu siç janë gjërat, kompetenca plotësuese e Unionit Evropian në lëmin e politikës së punësimit do të mbetet në masë të madhe pa ndikim, po që se nuk ekzistojnë instrumentet e “forta”, të detyrueshme.
- Në fund të fundit, duket se të rëndësishme margjinale janë edhe ndikimet në nivelin e punësimit, që gjer para do kohe në nivel të mesatares evropiane ka shfaqur tendencë të një rritjeje të paktë.

Sa i përket qëllimit të saj themelor, strategjia evropiane e punësimit u mbetet besnike bindjeve themelore monetare nga vitet e tetëdhjeta, ashtu që pikëmbështetja e tyre gjendet në anën e ofertës në tregun e punës.

Politika e arsimit:

Në shërbim të ekonomisë

Prej vitit 2000 politika e arsimit duhet t’i shërbejë realizimit të synimeve të parashtruara në Lisbon. Në relacion me ekonominë, politika e arsimit përkufizohet me këtë rast si pjesë e strategjisë evropiane të punësimit. Këshilli i Evropës në Barcelonë ka nxjerrë në vitin 2002 “Programin e punës për aplikimin e qëllimeve të sistemit të arsimit të përgjithshëm dhe profesional në Evropë”. Është përkufizuar synimi drejt një cilësie më të lartë të sistemit të arsimit të përgjithshëm dhe profesional për të gjithë njerëzit dhe drejt hapjes së arsimit të përgjithshëm dhe profesional ndaj botës.

Në esencë kemi të bëjmë me atë që është e nevojshme të përmirësohet cilësia e fuqisë punëtore në vendet – anëtare të Unionit Evropian. Meditimet për rolin e ardhshëm të sistemit të arsimit pa mëdyshje janë formuluar si “të pri-rura ndaj ekonomisë”, me ç’rast arsimit nuk luan ndonjë rol eksplicit si parakusht për angazhim shoqëror dhe kohezion social.

Politika sociale dhe siguria sociale:

Në kursin drejt shtetit aktiv social?

Unë ndërkohë Unioni Evropian është aktor i rëndësishëm edhe në fushat esenciale, siç është siguria sociale dhe politika sociale. Metoda e koordinimit të hapur për shkak të llojllojshmërisë së sistemeve nacionale është dashur ta dëshmojë karakteristikën e vet të metodës së re të udhëheqjes. Në lëmin e pensioneve, si nga më të rëndësishmit janë formuluar qëllimet vijuese: pensionet e nivelit përkatës, qendrueshmëria financiare e sistemeve të pensionit dhe modernizimi i tyre. Hiqet dorë, ndërkaq, si nga indikatorët kuantitativ, po ashtu edhe nga rekomandimet. Në fushën e kufizimeve sociale – apo të shprehur përmes raportit pozitiv, të pjesëmarrjeve sociale – dëshminë më të prekshme e paraqet katalogu ekzistues i indikatorëve. Më tutje planifikohet zhvillimi i qëllimeve kuantitative për reduktimin e kufizimeve sociale gjer në vitin 2010 në bazë të



Kohezioni social: Qëllim i mëvetësisshëm dhe mjet për zhvillimin e ekonomisë

Këtyre indikatorëve. Është arritur marrëveshja për një varg prioritetesh të përbashkëta për çdo politikë të veçantë nacionale, që shkrihen në dëndencën e formësimit të “shtetit aktiv social”.

Në asnjërin nga këto dy fusha të theksuara nuk ka përvoja të mjaftueshme që do të mundësonin dhënien e vlerësimeve të përkohshme. Unioni Evropian ka një numër të vogël kompetencash dhe dallimet institucionale dhe programore në mes të vendeve anëtare e vështirësojnë veprimin e përbashkët.

Qëndrueshmëria financiare e sistemeve të pensioneve, që është formuluar si qëllim, nga njera anë qendron në lidhje me politikën fiskale, kurse nga ana tjetër me nënqëllimin e parashtruar në Lisbonë, që është e nevojshme të rritet kuota e punësimit të personave të moshuar, që përseri shpie drejt shtimit të vjetërsisë efektive për dalje në pension për një grupacion të caktuar të banorëve.

Politika e punësimit, politika e arsimit dhe politika sociale: Përparësi konkurruese

Në lëmin e politikës së punësimit, të arsimit dhe të politikës sociale të Unionit Evropian, parimi i “përparësisë së tregut të brendshëm” është zëvendësuar me “përparësinë e konkurruesës”. Unioni Evropian në fushat e theksuara politike vertetë nuk disponon me instrumentët e domosdoshëm me anë të cilëve do të inicone vetë ndryshimet që janë të nevojshme nga kënvështrimi i saj. Metoda e koordinimit të hapur është metodë e butë që nuk ka karakter detyrues. Politika do të mund të bëhet e efektshme po qe se vertetë do të mësonim nga njëri tjetri, pastaj po qe se opinioni profesionist dhe aktorët do t’i pranonin rezultatet dhe t’i përfshinin në aktivitete e tyre të lobimit dhe po qe se ekziston një interesim i gjërë i mediave.

A ekziston mundësia që politika e punësimit, e arsimit dhe politika sociale të lirohet nga përqimi i konkurruesës? Me siguri vetëm po qe se do të ishin evidente zhvillimet engjashme me ato nga fundi i viteve të nëntëdhjeta, që do të paralajmëronin “momentin socialdemokratik” të dytin me rradhë. Shtrirja në vendet me karakter social demokratik, siç ka qenë në një kohë rasti i Suedisë dhe Austrisë, mirëpo nuk ka gjasa dhe shpresa të mëdha për përtëritjen e dominimit social demokrat në vendet e mëdha – anëtare, pa marrë parasysh ndryshimet programore në këto fusha politike, që ekzistojnë në mes tyre.

Po qe se modeli social evropian dallon nga regjimi social i vendeve të tjera industriale, para së gjithash për nga ajo që kohezioni social parashtrohet si qëllim prioritar, atëherë politikanët e Unionit Evropian duhet që në mënyrë përkatëse të vlerësohen sipas asaj se a eforcojnë, apo e dobësojnë atë qëllim.

Të fillojmë me politikën ekonomike, ndaj së cilës Unioni Evropian bën ndikim relativisht të madh. Po qe se bëjmë një rezymë të situatës, integrimi evropian me ndihmen e rregullave të veta ekonomike - politike paraqet sfida për modelin social evropian, pas që nga njera anë “në mënyrë natyrore” shkakton efekte të rindarjes, kurse nga ana tjetër i ndryshon kushtet për masa koshiente, politikisht të dëshirueshme të rindarjes (Pakti i stabilitetit dhe i shtimit, politika e konkurruesës, etj.). Efektet e rindarjes, me këtë rast – nga këndvështrimi mbi nacional – pjesërisht mund të vlerësohen pozitive, po qe se del se shkojnë në të mirë të popullatës së varfër nga vendet – anëtare, që nuk janë aq të fuqishme. Marrë në tërësi pasojat sillen brenda suazave, që nuk do të duhej të jepnin shkas për frikë që integrimi evropian do të rrezikonte model social evropian.

Në lëmin e politikës së punësimit, të arsimit dhe të politikës sociale, (duke përfshirë sigurinë sociale) kompetencat e Unionit Evropian janë më të vogla, e së këndejmi është më i vogël edhe

ndikimi i tij. Mirëpo, integrimi evropian përherë e ka verifikuar se çfarë është kontributi në aspektin e theksuar të atyre fushave politike, të cilat janë në lidhje të ngushtë me zhvillimin ekonomik. Kjo është bërë duke shfrytëzuar metodat që rrjedhin nga fusha e ndërmarrësisë me qëllim që të gjitha përpjekjet të orientohen drejt përparimit të konkurrencës, në mënyrë që Evropa gjer në vitin 2010 të zhvillohet në hapësirë më dinamike ekonomike që mbështetet në dije.

A paraqet një botëkuptim i tillëkërcnim për modelin social evropian? Jo meçdo kusht, sepse, të përkujtojmë: modeli social evropian dallon nga modelet e tjera nga fakti që kohezioni social nuk është vetëm qëllim i vetëvetës, por paraqet mjet për arritjen e zhvillimit ekonomik, që po ashtu duhet të sigurojë bazë materiale të modelit social evropian. Ky "instrumentalizim" nuk është vertetë arsye e ekzistimit, por në një masë të caktuar paraqet sigurimin jetësor të modelit social evropian. Për sa kohë që kohezioni social të shpjegohet si pengesë rënduese për dinamikën ekonomike, si faktor i rendomtë e shpenzimeve, gjer atëherë edhe modeli social evropian do të jetë temë për diskutim. Për këtë arsye ringjallja e modelit social evropian, thjesht është e domosdoshme në mënyrë që ai të vëhet në shërbim të konkurrencës.

Jo vetëm fakti që kohezioni social paraqet një nga tre qëllimet e strategjisë evropiane të

punësimit, si dhe temën qendrore në njërën nga proceset e metodës së koordinimit të hapur, por edhe qëllimi që të gjitha fushat e "buta" në të ardhmen bashkërisht t'i plotësojnë fushat e "forta" politike, mund që nga kjo perspektivë të jetë përparësi për zhvillimin e mëtejshëm të modelit social evropian.

Me këtë rast, natyrisht, nuk pritet që Unioni Evropian në mënyrë ofanzive do të marrë mbi vete kultivimin e modelit ekzistues. Paradigma që zhvillohet në vend të shtetit të mirëqënies, që i shërben kryesisht klientelës së vetë pasive, tani përshkruan shoqërinë e mirëqënies, e cila mbështetet në qytetarët dhe qytetaret aktive, të cilët shteti në rend të parë i aktivizon, kurse në instancën e fundit i përkrah edhe në aspektin financiar. Kjo mund të shkojë në të mirë të angazhimit shoqëror, që përseri mund t'i kontribuojë forcimit të modelit social evropian.

Gjithsesi, modeli social evropian i së ardhmes formësohet në suazat kombëtare, politike dhe shoqërore dhe në ato fusha në një kohë të afërt do të zhvillohen konflikte esenciale. Që kjo edhe të ndodhë kujdesen partitë (nacionale) politike: pasi që kompetencat më të rëndësishme tashmë janë bartur në nivelin evropian, ato nuk do të lejojnë që t'u merren kompetencat për fushat e tjera politike, që janë me rëndësi për modelin social evropian.



DSP dhe mediat Anja Kruke (Anja Kruke)	www.http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/19.gledati%20svet%20izn ova.pdf
Mbi modernizimin e programit të Berlinit – Pa pietet të rrejshëm! Fric V. Šarpf (Fritz W. Scharpf)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/20.za%20modernizaciju%20berlinskog%20programa.pdf
Një vit më vonë: Evropa Lindore dhe e Mesme në krizën e qasjes Mihael Erke (Michael Ehrke)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/21.godinu%20dana%20posle.pdf
Mbi aplikimin fleksibil të aplikimit të Paktit të stabilitetit Angelika Šval-Diren (Angelica Schwall-Düren)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/22.fleksibilna%20primena%20umesto%20striktnog%20pridrzavanja.pdf
Kapitalizmi dhe ekonomia sociale e tregut Iring Fečer (Iring Fetscher)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/23.kontroverze.pdf
Internacionalja socialiste dhe demokracia globale Kristof Cepel (Kristoph Zöpel)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/12_socijalisticka_internacionala_i_%20globalna_demokratija.pdf
Iluzioni liberal pas zgjedhjeve: Tregu i përbashkët pa union politik Mihael Dauderštet (Michael Dauderstädt)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/13_liberalna_iluzija_posle_odrzanih_referenduma.pdf
Aksentet e reja në politikën sociale Volfgang Šreder (Wolfgang Schröder)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/26.novi%20akcenti%20u%20socijalnoj%20politici.pdf
Mbi dobëtë e koalicionit të madh në periudhat kalimtare Klaus Šenhoven (Klaus Schönhoven)	http://www.fes.org.yu/thira_files/publikacije/2005/27.stabilnost%20umesto%20zatisja.pdf

